



**KOMUNA E PRISHTINËS**  
**RAPORT MUJOR**

Drejtoria	Drejtoria e Inspeksionit
Periudha raportuese	<b>Janar, 2016</b>
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Zana Gojani

***PËRMBLEDHJE***

Drejtoria e Inspeksionit, gjatë muajit janar, përveç punëve të përgjithshme të përditshme, është marrë edhe me eliminimin e bllokimeve të mundshme për procesin e ristrukturimit.

***AKTIVITETET E PLANIFIKUARA***

Për muajin janar ishte parashikuar të finalizohet Plani i veprimit i vitit 2016 dhe identifikimi i ngecjeve apo hapësirave problematike të ristrukturimit.

***AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA***

- Sektori i ndërtimit gjatë këtij muaji ndërmori 3 aksione rrënimi;
- Sektori i komunikacionit konfiskoi 68 automjete;
- Sektori komunal ka bërë largimin e 19 shitësve ambulantë.

Gjatë muajit janar, përveç detyrave të përditshme (skanimit të terrenit, ndërhyrja në rast nevojë dhe gatishmëria ndaj ankesave të qytetarëve), finalizoi edhe përshkrimin e detyrave të reja për Sektorin e rendit komunal, dhe sektorët e tjerë që parashihen të fuzionohen në muajin pasues.

## ***AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR***

- Kalimi i Sektorit të pylltarisë nga Drejtoria e Zhvillimit në Drejtorinë e Inspeksionit;
- Fuzionimi i përgjegjësive të inspektorëve të bujqësisë me Sektorin e mbrojtjes së pyjeve;
- Finalizimi i ligjshmërisë së detyrave të reja të Sektorit të rendit komunal;
- Identifikimi i trajnimeve të nevojshme për aftësimin e mëtutjeshëm të inspektorëve me përgjegjësitë e reja.

### ***Takimet me palë:***

- Drejtori – 10 palë,
- Sektori i ndërtimit – 70 palë,
- Sektori komunal – 65 palë,
- Sektori i komunikacionit – 30 palë
- Sektori sanitar – 30 palë.

### ***Takimet me institucione të tjera:***

- DUNMM,
- NPB,
- Policia e Kosovës,
- Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor,
- Përfaqësues të Trafikut Urban,
- Drejtoria e Shërbimeve Publike,
- Drejtoria e Infrastrukturës Lokale,
- GIZ etj.

Sektori i ndërtimit kishte takime të vazhdueshme, me qëllim të bashkëpunimit dhe ngritjes së efikasitetit, me Drejtorinë e Urbanizmit kishte 25 takime, kurse me NPB-në kishte 5 takime.

Takime u mbajtën edhe mes Ministrisë së Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor dhe Sektorit komunal.

Ky sektor gjithashtu kishte takime edhe me përfaqësuesit e Trafikut Urban, me qëllim të gjetjes së zgjidhjes së problemeve me taksitë ilegale.

Sektori i komunikacionit kishte takime të vazhdueshme me DSHPMSh-në dhe Policinë e Kosovës, me qëllim të vlerësimit të sigurisë rrugore. Si rezultat i këtyre takimeve, Sektori i komunikacionit përpiloi raport të gjendjes, që do të merret parasysh gjatë intervenimeve për përmirësimin e gjendjes në rrugë.

### ***Lëndët e pranuar:***

- Sektori komunal – 28 lëndë,
- Sektori i komunikacionit – 80 lëndë,
- Sektori i ndërtimit – 34 lëndë,
- Sektori sanitar – 23 lëndë.

### ***SFIDAT***

Lokacionet legale për dukuritë në vijim:

- Deponitë për mbeturina inerte/të amvisërisë,
- Tregu i kafshëve – thertoret,
- Tregu i druve, thëngjillit, gëlqeres etj.

### ***REKOMANDIME***

- Shtimi i bashkëpunimit me Policinë e Kosovës, për kohën që nuk mbulohet me policë sekondarë.
- Bashkëpunimi mes inspektorëve komunalë dhe inspektorëve qendrorë për veprimtari të veçanta, për shembull: kontrolle, mostra - analiza për produktet me prejardhje shtazore-bimore.

### ***AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES***

- Finalizimi i procesit të ristrukturimit.